	<b>PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS</b>		<b>F3</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

## Përshkrimi i detyrave të punës

<b>Pozita</b>	Konsulent për vlerësimin afatmesëm të zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 - 2022
<b>Kodi dhe emërtimi i aktivitetit</b>	KEEN A.3.2. – Monitorimi i politikave në nivel qendror dhe lokal
<b>Zëri buxhetor i aktivitetit</b>	ZB. 113
<b>Numri i ditëve të punës</b>	Deri në 19 ditë pune
<b>Periudha e angazhimit</b>	04 tetor – 30 nëntor 2019

### Qëllimi i konsulencës

Qëllimi i kësaj konsulence është ofrimi i ekspertizës për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale, përkatësisht, vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve dhe arritjen e treguesve të përcaktuar në objektivat strategjik .


### Përshkrimi i projektit

Projekti KEEN është koalicion strategjik i katër organizatave të shoqërisë civile të cilat angazhohen në fushën e arsimit, punësimit dhe politikave sociale. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian dhe ka për qëllim përmirësimin e punësueshmërisë së grupeve në nevojë në Kosovë dhe përfshirjen e tyre në zhvillimin e politikave, në vendimmarrje dhe në monitorimin e zbatimit të tyre në nivel qendror dhe lokal. KEEN synon të përafrojë ndërlidhjen ndërmjet programeve të arsimit dhe aftësimit me kërkesat e tregut të punës.

### Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i konsulencës është hartimi i raportit i cili vlerëson zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e treguesve të përcaktuar në objektivat strategjik në Strategjinë Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale 2018 - 2022. Angazhimi përfshin aktivitetet në vijim:

- Zhvillimi i planit të punës për hartimin e raportit;
- Shqyrtimi i Strategjisë Sektoriale të Punës dhe Mirëqenies Sociale 2018 – 2022, përfshirë objektivat strategjik, planin e veprimit dhe treguesit vjetor;
- Hartimi i planit dhe metodologjisë për vlerësimin e zbatimit të objektivave strategjik;
- Përpunimi i të dhënave të mbledhura;
- Hartimi i raportit duke u bazuar në të gjeturat nga hulumtimi;
- Prezantimi i raportit.

 <small>RRJETI I KOSOVËS PËR ARSIM DHE PUNËSIM</small>	<b>PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS</b>		<b>F3</b>
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

### **Rezultatet e pritshme**

- Hartohet plani i punës;
- Përpunohen të dhënat e mbledhura (sasiore dhe cilësore) nga MPMS;
- Hartohet raporti i cili përmban të dhëna sasiore dhe cilësore të cilat pasqyrojnë zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e treguesve të objektivave strategjik të Strategjisë Sektoriale për Punë dhe Mirëqenie Sociale.
- Raporti përmban/ofron rekomandime për përmirësim e gjendjes, përkatësisht tejkalimin e sfidave të identifikuar.
- Të gjeturat nga raportet prezantohen dhe diskutohen me të gjitha palët në fushën e punësimit.

### **Kualifikimet**

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master, në fushën e shkencave sociale.
- Njohje e mirë e fushës së punësimit dhe mirëqenies sociale në Kosovë.
- Njohuri të mira të metodave themelore të hulumtimit në shkencat shoqërore.
- Përvojë të mëhershme në hartimin e raporteve në fushën e punësimit dhe mirëqenies sociale.
- Përvojë të mëhershme në vlerësimin e fushës së punësimit dhe mirëqenies sociale.
- Njohje e shkëlqyeshme e gjuhës shqipe dhe angleze.
- Shkathtësi të mira të komunikimit dhe prezantimit të të gjeturave nga raportet.

### **Raportimi**

Konsulenti i raporton menaxherit të projektit.

Dokumenti duhet të dorëzohet në formë elektronike (në formatin Ms Word, fonti Times New Roman, madhësia e fontit 12), në gjuhën shqipe apo angleze.